



BULETINI TREMUJOR
NR 51 – VITI XIII – TM3 2020

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS

TRUSTORJA

PERFORMANCA

PERIUDHA	1 MUAJ	3 MUAJ	VITI AKTUAL	3 VJET	5 VJET	NGA THEMELIMI
REZULTATI	+0.95%	+1.18%	+0.23%	+5.59%	+18.95%	+51.41%
BENÇMARKU*	-0.28%	+0.95%	-0.85%	+3.44%	+5.77%	+37.78%

* INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT SIKURSE I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

LËVIZJET MUJORE

ÇMIMI I AKSIONIT		KTHIMI BRUTO	KTHIMI NETO
KORRIK	+0.95%	€19.8 mln	€19.1 mln
GUSHT	+1.18%	€24.7 mln	€24.1 mln
SHTATOR	-0.60%	€-11.8 mln	€-12.5 mln
TREMUJORI	+1.53%	€32.7 mln	€30.7 mln

KONTRIBUIMI

KONTRIBUTE TË REJA		LLOGARI TË REJA	LLOGARI AKTIVE
KORRIK	€17.13 mln	4,423	336,283
GUSHT	€15.85 mln	2,358	343,379
SHTATOR	€15.43 mln	2,705	350,087
TREMUJORI	€47.41 mln	9,486	343,250*

*mesatarja tremujore

PENSIONIMET

TË PENSIONUAR			ARSYET		
		SHUMA E TËRHEQUR	PENSION MOSHE	RASTE VDEKJESH	TË TJERA
KORRIK	595	€2.72 mln	396	124	75
GUSHT	606	€6.19 mln	406	135	65
SHTATOR	737	€5.81 mln	567	109	61
TREMUJORI	1,938	€14.72 mln	1,369	368	201

PËRMBLEDHUR

	TM3	TM2
ÇMIMI I AKSIONIT	€1.5141	€1.4913
MJETET NËN MENAXHIM	€2,068,304,440.50	€2,004,007,875.44
TARIFA INVESTUESE	€1,701,088.48	€1,758,209.48
TARIFA OPERACIONALE	€335,062.89	€332,815.56
INVESTIMET NË KOSOVË	€616,614,573	€588,555,803
INVESTIMET JASHTË	€1,408,353,687	€1,125,221,763
TË PAINVESTUARA (NË BQK)	€44,874,314	€291,714,931
LLOGARI NË eTRUSTI	194,756	160,505
SHËRBIMET E OFRUARA NGA FKPK	51,554	30,967

PLASMANET DHE PERFORMANCA

MENAXHUESI FONDI BANKA BROKERI	EMËRTIMI I FONDIT OSE NUMRI ISIN	PLASMANET FUNDI TM3	KTHIMI BRUTO NË INVESTIME
Vanguard	Global Stock Index Fund	€78,811,734	€4,017,120.49
Nordea	1-Stable Return Fund	€329,521,796	€3,333,307.81
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€84,607,954	€(945,340.27)
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€337,129,343	€11,833,086.17
AXA	Global Inflation Linked B.	€152,600,771	€1,444,932.43
Amundi 3M	Amundi 3M - I	€175,621,435	€(119,983.15)
BNP Parvest	Diversified Dynamic	€104,640,396	€1,971,268.21
ERSTE (SP500 MinVol ETF)	ETF-IE00BYX8XD24	€21,969,818	€1,606,982.73
ERSTE (iShares MSCI EUR)	ETF-IE00B86MWN23	€30,314,935	€370,633.69
ERSTE (Invesco QQQ ETF)	ETF-US46090E1038	€93,135,504.83	€6,092,008.49
Thesari i Kosovës ¹⁾	Obligacione	€432,540,335	€2,379,237.01
Banka në Kosovë ¹⁾	Depozita me afat	€184,074,238	€670,261.02
BQK - të gatshme	Të painvestuara	€44,874,314	€(32,045.16)
Të hyra të tjera		--	€81,938.80
GJITHSEJ		€2,069,842,574	€32,703,408.27

¹⁾ Këto janë investime me afat të caktuar maturimi.

PROJEKTLIGJI QË MUNDËSON TËRHEQJEN E 10%-SHIT KALOI NË LEXIM TË PARË

Më 12 tetor Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim, në lexim të parë, ligjin për rimëkëmbjen ekonomike, ku përfshihet edhe ndryshimi ligjor që mundëson tërheqjen e 10% të bilancit nga Trusti. Kuptohet, sipas procedurave legjislative, Kuvendi do të duhet miratojë këtë projektligj edhe në leximin e dytë.

Pas leximit të dytë, i njëjti ligj do të duhet të dekretohet nga Presidenti. Në momentin që dekretohet ligji nga Presidenti, dhe më pas publikohet në Fletoren Zyrtare, ai hynë në fuqi. Atëherë Trusti do t'i bëjë të ditura të gjitha detajet e aplikimit për tërheqjen e 10%-shit.

PËRFAQËSUES TË TRUSTIT NË TAKIM NË ANËTARË TË ODËS AMERIKANE

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë organizoi më 3 shtator një forum virtual gjatë të cilit u diskutua strategjia e investimeve e Fondit Pensional (Trustit) si dhe mundësitë që ofrohen për sektorin privat në Kosovë. Gjatë këtij forumi, përfaqësuesit e bizneseve, anëtare të Odës Ekonomike Amerikane, kishin mundësinë të informoheshin rreth strukturës dhe kriterëve të kësaj strategjie.

Drejtori Menaxhues i Fondit të Kursimeve Pensionale, Adrian Zalli, theksoi se ky fond momentalisht posedon mjete në vlerë mbi dy miliardë euro. Sipas tij, mjetet e Fondit Pensional investohen me qëllim të rritjes së fitimit vetëm në interes të kontribuuesve, derisa parimet kryesore që duhet të ndiqen për realizimin e këtyre investimeve janë të përcaktuara me Ligjin për Fondin Pensional. Zalli tha se këto parime duhet të garantojnë sigurinë e fondit, shumëllojshmërinë e investimit, fitimin maksimal në përputhje me sigurinë e fondit si dhe mirëmbajtjen e likuiditetit adekuat. Ai potencoi se parim i Bordit Drejtues është rritja e investimit të mjeteve në Kosovë, përmes depozitave bankare por edhe pjesëmarrjes në tregun e letrave me vlerë, të cilat pastaj Qeveria e Republikës së Kosovës i investon aty ku është më e nevojshme.

Valdrin Kasumaj, anëtar i bordit në Fondin Pensional të Kosovës, theksoi se kufizimet brenda mandatit ligjor të Fondit Pensional ndikojnë në mundësinë e këtij fondi për të përkrahur bizneset në Kosovë, derisa shtoi se gjatë vitit 2020 pjesëmarrja e Fondit në tregun e letrave me vlerë por depozitat bankare në vend është rritur dhe vazhdon të rritet.

Hekuran Murati, kryesues i Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Transfere, derisa theksoi se oferta për produkte financiare në Kosovë është paksa e kufizuar, tha se për ndërmarrjet duhet të merren parasysh nevojat e investimit duke u bazuar në ciklin e zhvillimit të tyre. Sipas Muratit, për bizneset e reja është rëndom më problem qasja në financa krahasuar me bizneset më të pjekura, të cilat mund të jenë më të parashikueshme për sektorin huadhënës.

Mërgim Cahani, kryeshef ekzekutiv në Gjirafa, duke folur për një periudhë dhjetë vjeçare theksoi se tani kompanitë me vlerën më të madhe janë padyshim ato në sektorin e teknologjisë. Cahani përmendi faktin se potenciali më i madh për zhvillimin ekonomik të vendit qëndron pikërisht në këtë sektor prandaj i njëjti duhet të mbështetet më shumë përmes krijimit të mundësive për investime brenda shtetit.

PUBLIKON:

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës

Tetor 2020

AUTOR:

Jeton Demi

ADRESA:

Rr. "Agim Ramadani" #182-184 10000 Prishtinë,
Kosovë

E-MAIL & UEB

info@trusti.org www.trusti.org



TrustiPensional